

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË****Bordi****VENDIM****Nr. 132, Datë 10.08.2020****MBI****KUALIFIKIMIN DHE PAJISJEN ME ÇERTIFIKATË TË GARANCISË SË ORIGINËS PËR IMPIANTIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE “HEC BANJË”, TË SHOQËRISË “DEVOLL HYDROPOWER” SHA.**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; nenit 16 të Ligjit nr. 7/2017, “Për Nxitjen e Përdorimit të Energjisë nga Burimet e Rinovueshme”; neneve 8 dhe 11 të “Rregullores për Lëshimin, Transferimin dhe Anullimin e Garancive të Originës për Energjinë Elektrike të Prodhuar nga Burimet e Rinovueshme”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s Nr. 229, datë 20.12.2019 dhe nenit 19, gërma d), të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.08.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 94/1 Prot, datë 07.08.2020, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, lidhur me miratimin e kualifikimit të impiantit dhe pajisjen me “Çertifikatë të garancisë së origjinës” për impiantit e prodhimit të energjisë elektrike “HEC Banjë”, të Shoqërisë “Devoll Hydropower” sha,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s, me vendimin Nr. 88, datë 20.05.2020, ka filluar procedurën për kualifikimin dhe pajisjen me “Çertifikatë të Garancisë së Originës”, për impiantit e prodhimit të energjisë elektrike “HEC Banjë”, të shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje me shkresën nr. 684/1 Prot., datë 29.05.2020, është kryer njoftimi i vendimit të fillimit të procedurës.
- Shoqëria “OST” sh.a. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 684/3, datë 12.06.2020, ka përcjellë informacionin në lidhje me marrëveshjen e shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sha me OST sh.a.
- HEC Banjë ka filluar veprimtarinë e tij si prodhues në datën 03.09.2016.
- Shoqëria “Devoll Hydropower” sh.a., kërkesën për pajisjen me Çertifikatën e Garancisë së Originës për impiantit e prodhimit të energjisë elektrike HEC “Banjë”, e ka shoqëruar edhe me dokumentacionin përkatës konform “Rregullores për Lëshimin, Transferimin dhe Anullimin e Garancive të Originës për Energjinë Elektrike të Prodhuar nga Burimet e Rinovueshme”, miratuar nga Bordi i ERE-s me vendimin Nr. 229, datë 20.12.2019.

- Dokumentacioni i këtij aplikimi është tërësisht i plotësuar dhe HEC Banjë i shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a., përmbush të gjitha kriteret për t’u kualifikuar si impiant prodhues i energjisë elektrike dhe për t’u pajisur me Çertifikatën e Garancisë së Origjinës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE :

**Vendosi:**

1. Të kualifikojë impiantin e prodhimit të energjisë elektrike “HEC Banjë”, të shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a.
2. Të pajisë me Çertifikatën e Garancisë së Origjinës impiantin e prodhimit të energjisë elektrike “HEC Banjë”, të shoqërisë “DEVOLL HYDROPOWER” sh.a., për një afat 12-mujor.
3. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim, brenda 7 ditëve nga data e marrjes së vendimit në ERE dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**